

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7878
E premte, 6 shtator 2024
Çmimi 0.50

Në 27-vjetorin e ikjes
në amshim e kujtohet
Shën Tereza



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRJA E PUNËVE TË JASHTME E FINLANDËS, ELINA VALTONEN,
VJEN PËR VIZITË NË KOSOVË

FAQE 4-5

VALTONEN: FINLANDA E GATSHME TA NDIHMOJË KOSOVËN PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE ME SERBINË



Ministrja e Punëve të Jashtme e Finlandës, Elina Valtonen, ka theksuar të enjten në Prishtinë, se shteti që ajo përfaqëson është i gatshëm të bëjë "çfarëdo që është e

mundur" për ta mbështetur Kosovën në rrugën për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Valtonen ka thënë se Finlanda është pajtuar me

marrëveshjen që kanë arritur palët vitin e kaluar. Ndërkaq përfaqësuesit e Kosovës e kanë falënderuar për mbështetjen që shteti i saj ka dhënë për Kosovën në çdo etapë

**HARADINAJ:
POLICIA SOT
NUK E KA
KUJDESIN E
QEVERISË** F.3



**MPJD U BËNË
THIRRJE SHITETASVE
TË KOSOVËS
DHE MËRGATËS
T'I SHMANGIN
PIKAT KUFITARE
ME SERBINË** F.3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

**SHTATORJA E GJERGJ
KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT
DHE SINDROMI I FREGOLIT** F.7

Bardhyl MAHMUTI,
politolog



AKTUALE



**SHBA AKUZON RUSINË PËR FUSHATA
DEZINFORMIMI PËR TË NDIKUAR
TEK ZGJEDHJET PRESIDENCIALE** F.3

**KURTI DHE ATIQI DISKUTOJNË
PËR QEVERISJEN KOMUNALE,
ARRITJET DHE SFIDAT
NË MITROVICËN E VERIUT** F.3

EKONOMI

**'TREPÇA' EKSPORTON
237 50 TONELATA KONCENTRAT
TË PLUMBIT** F.8

**'VJELJA E RRUSHIT KOSOVA 2024'
NË SUHAREKË: KOSOVA KA NEVOJË
PËR MBËSHTETJE TË PRODHIMIT** F.8

SPORT



**KOSOVA SYNON FITORE NDAJ
RUMANISË** F.10

Papa kërkon që feja të mos përdoret për nxitje të konflikteve

XHAKARTË, 5 SHTATOR - Papa Françesku bëri thirrje që feja të mos përdoret për të nxitur konflikte. Ai nënshkroi një deklaratë me imamin e madh të Indonezisë para mbajtjes së një meshe në Xhakartë.

Nënshkrimi i deklaratës në xhaminë Istiqlal ishte një prej hapave të fundit kyç të vizitës treditore të Françeskut në Indonezi, shtetin me popullsinë më të madhe myslimane në botë.

Harmonia fetare ka qenë një qendër të udhëtimit të papës.

Në fjalimin në xhami, Françesku tha se "nese shikojmë më thellë... ne do ta zbulojmë se të gjithë jemi vëllezër, të gjithë pelegrinë, të gjithë në rrugën tonë për të

Zoti".

Teksa paralajmëroi kundër përdorimit të fesë për të nxitur konflikte, ai tha se kriza mjedisore është kërcënim ekzistencial për civilizimin njerëzor.

Gjatë vizitës në Indonezi ai u takua me udhëheqësit e gjashtë feve zyrtare në Indonezi. "Ne duhet të marrim përgjegjësinë që të adresojmë me seriozitet krizat që kërcënojnë të ardhmen e njerëzimit, sikurse luftërat dhe konfliktet... dhe krizat mjedisore, të cilat janë pengesë për rritjen dhe bashkëjetesën e popujve", tha Françesku.

Gjatë vizitës së papës në xhaminë Istiqlal, kryemami Nasaruddin Umar lexoi pjesë të

Kuranit dhe një vajzë e verbër një pjesë nga Bibla.

Kjo xhami gjendet përballë katedrales në Xhakartë dhe dy objektet janë të lidhura "nga tuneli i miqësisë", si një simbol i vëllazërisë fetare.

Françesku vizitoi tunelin para se të takohej me kryeimamin.

Françesku ka vizituar disa shtete me shumicë myslimane dhe më 2019 ai vizitoi Emiratet e Bashkuara Arabe dhe nënshkroi një dokument për vëllazëri mes popujve me imamin e madh të këtij shteti.

Në Indonezi, 242 milionë persona, apo 87 për qind e popullsisë janë myslimanë. Ndërkaq, afër 8 milionë, apo afër 3 për qind janë katolikë.



ShBA-ja akuzon Rusinë për fushata dezinformimi për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale

WASHINGTON, 5 SHTATOR - Administrata e presidentit të ShBA-së, Joe Biden, e ka akuzuar Rusinë se është angazhuar në fushata dezinformimi që kanë në shënjestër zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara dhe njoftoi për masa të gjera ndaj këtyre përpjekjeve, përfshirë akuza penale kundër dy punonjësve të medias shtetërore ruse RT, si edhe sekuestrimin e faqeve të internetit të përdorura nga Kremli për të përhapur dezinformata.

Agjencitë e zbulimit kanë akuzuar më parë Rusinë për ndërhyrje në zgjedhje përmes dezinformatave. Por prokurori i përgjithshëm Merrick Garland, i cili deklaroi qëndrimin e administratës, foli hollësisht për shqetësimin e thellë të Shteteve të Bashkuara për këtë fushatë, si dhe njoftoi për veprime ligjore kundër atyre që dyshohet



se janë përfshirë në këto përpjekje.

Mes të tjerash, Garland tha se Rusia përmes medieve shtetërore ka përdorur figura amerikane me ndikim dhe me audiencë të gjerë në mediet sociale, pa dijeninë e

tyre, për të përhapur dezinformata dhe propagandë.

Shqetësimet më të mëdha lidhur me Rusinë përqendrohen te sulmet kibernetike dhe fushatat e dezinformimit me synimin për të ndikuar në zgjedhjet e nëntorit.

Taktikat përfshijnë përdorimin e medieve shtetërore si RT për të përhapur mesazhe dhe përmbajtje kundër Shteteve të Bashkuara, si dhe faqe interneti dhe llogari mediashe sociale të rreme që përforcojnë ato pretendime dhe i shpërndajnë përmes komunikimeve online të amerikanëve.

Në një rast, dy punonjës të RT-së akuzohen për financimin e fshehtë të një kompanie që krijon produkte digjitale me qendër në Tenesi për publikimin e rreth 2 000 videoeve që përmbanin propagandë ruse. Të pandehurit, të cilët nuk janë kapur, përdorin identitete të rreme dhe kompania nuk ishte në dijeni se po përdorej nga Rusia. "Njoftimi i sotëm nxjerr në pah se deri ku shkojnë disa qeveri të huaja për t'i minuar institucionet demokratike

amerikane", tha Departamenti i Shtetit. "Por këto qeveri të huaja duhet të dinë se ne nuk do të tolerojmë aktorë të huaj keqdashës që qëllimisht ndërhyjnë dhe minojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme".

Në një fjalim muajin e kaluar, zëvendësprokurorja e përgjithshme Lisa Monaco tha se Rusia ishte kërcënim kryesor ndaj zgjedhjeve. Presidenti rus Vladimir Putin dhe njerëzit që punojnë për Rusinë po përdorin teknika gjithnjë e më të sofistikuar në operacionet e tyre të ndërhyrjes. "Ata po vënë në shënjestër grupe të veçanta demografike dhe votues të shteteve të pavendosura në një përpjekje për t'i manipuluar rezultatet e zgjedhjeve presidenciale dhe të kongresit", tha ajo.

Netanyahu kërkon kontroll të përhershëm të kufirit në mes të Gazës dhe Egjiptit

JERUSALEM, 5 SHTATOR - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka thënë se Izraeli duhet të ketë kontroll të përhershëm të kufirit në mes të Gazës dhe Egjiptit, duke këmbëngulur në qëndrimin e tij për një çështje që kërcënon t'i minojë përpjekjet për arritjen e një armëpushimi.

Komentet e Netanyahit vijnë ndërsa Shtetet e Bashkuara po hartojnë një propozim të ri që synon arritjen e armëpushimit dhe lirimin e pengjeve. Përpjekja synon t'u japë fund luftimeve gati 11-mujore.

Çështja e kontrollit të korridorit Filadelfi, një rrip i ngushtë toke përgjatë kufirit të Gazës me Egjiptin i marrë në kontroll nga trupat izraelite në maj, është bërë një pengesë qendrore në bisedime.

Hamasi kërkon tërheqjen e plotë të Izraelit nga Gaza në marrëveshjen e armëpushimit me shumë faza. Bisedimet po ndërmytetësohen nga Egjipti, Shtetet e Bashkuara dhe Katari. Egjipti ka kërkuar gjithashtu një afat konkret për largimin e trupave izraelite nga korridori Filadelfi.

Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilat vendosën marrëdhënie zyrtare me Izraelin në bazë të Marrëveshjes së Abrahamit të vitit 2020, kritikuan gjithashtu qëndrimin izraelit.

Duke folur me gazetarët e huaj, Netanyahu përsëriti qëndrimin se Izraeli duhet ta mbajë kontrollin e kufirit për ta parandaluar kontrabandën e armëve drejt Gazës dhe furnizimin e Hamasit. Ai tha se ishte një pjesë jetike e objektivit të luftës për të siguruar që Hamasi të mos përsëriste më sulmin e 7 tetorit ndaj Izraelit.



Haradinaj: Policia sot nuk e ka kujdesin e qeverisë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kur më 6 shtator 1999 u themelua policia jonë, filloi shtetndërtimi në fushën e sigurisë. "Nesër bëhen 25 vjet. E uroj Policinë në 25-vjetorin e themelimit! Do të kujtojmë përgjithmonë policët e rënë në detyrë. Kemi shumë punë për ta forcuar dinjitetin, kushtet dhe pajisjet e Policisë sonë. Prioritet do të jetë paga

minimale prej 1.000 euro brenda Policisë dhe sigurimi shëndetësor. Modernizimi i pajisjeve të Policisë do të bëhet gjithashtu. Policia sot nuk e ka kujdesin e qeverisë, por e ka presionin politik mbi të! Kurti edhe i sulmoi me gurë sa ishte në opozitë, edhe po e instrumentalizon Policinë për interesa elektorale sa është në qeveri", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Haradinaj ka thënë se Kurti të

premtën do t'i mbajë policisë fjalim prekës por, sipas tij, prapa fjalëve vetëm mashtrimin ka qëllim. "Ai nesër në 25-vjetorin e Policisë mund t'ju mbajë një fjalim prekës, por prapa fjalëve vetëm mashtrimin ka qëllim. Për pak javë kjo do të përfundojë. Policia është e Kosovës. Qëndroni të tillë. Mos u bëni instrument në duar të pasigurta!", ka shkruar Haradinaj.



Kurti dhe Atiqi diskutojnë për qeverisjen komunale, arritjet dhe sfidat në Mitrovicën e Veriut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, mirëpritën të enjten në Ballkonin e Hapur për një mëngjes pune, kryetarin e komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, nënkryetaren Katarina Adançiq dhe drejtues të drejtorive komunale të kësaj komune.

Temat qendrore ishin qeverisja komunale, arritjet dhe sfidat, dhe bashkëpunimi me nivelin qendror.

Kryeministri Kurti dhe ministrat Rashiq dhe Krasniqi u njoftuan



rreth punëve të drejtorive, shërbimeve komunale të cilat po shtohen në vazhdimësi, investimeve në mirëmbajtjen e

rugëve e hapësirave publike dhe bashkëpunimit me agjencitë qendrore. Nga drejtorët komunalë u veçua

progresi dhe përgatitjet për fillimin e procesit të legalizimit të objekteve dhe hartimit të planit zhvillimor, krijimi i databazës për rastet sociale që kanë nevojë për mbështetje institucionale, rekrutimi i stafit të ri profesional, funksionalizimi i zyrës komunale të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, ku deri më tani janë regjistruar 89 biznese, pastaj funksionalizimi i intranetit dhe fillimi i digjitalizimit të arkivit si dhe planet për ofrimin për herë të parë të shërbimeve digjitale përmes e-kioskut.

Gjatë takimit u diskutua edhe rreth mundësive për bashkëpunime të reja, përfshirë ato ndërmjet komunave në veri të vendit dhe për projekte të reja për çka është e nevojshme mbështetja e qeverisë.

Kryeministri Kurti i përgëzoi drejtuesit dhe stafin e komunës së Mitrovicës së Veriut për punën dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarë, pa dallim, për përbërjen multietnike të kabinetit qeverisës dhe për bashkëpunimin e mirë e profesional me ministrinë dhe Zyrën e Kryeministrit për realizimin e projekteve në interes të komunës.

Ai i ofroi kryetarit Atiq dhe nënkryetares Adançiq mbështetjen e plotë të tij edhe të ministrive të linjës për adresimin e kërkesave dhe propozimeve të tyre që për qëllim kanë zhvillimin ekonomik dhe social të komunës së Mitrovicës së Veriut dhe rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në 27-vjetorin e ikjes në amshim kujtohet Shën Tereza

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Në 27-vjetorin e ikjes në amshim është kujtuar Shën Tereza.

Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se në Ditën e Humanizmit, nderojmë jo vetëm jetën dhe trashëgiminë e një gruaje të jashtëzakonshme, por edhe vlerat që ajo mishëroi: dhembshurinë, dashurinë dhe shërbimin ndaj njerëzimit. "Nëna jonë Terezë mbetet një fanarë dhembshurie, përvullësie dhe shërbimi vetëmohues ndaj njerëzimit. Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, me krenari e identifikoi veten si shqiptare, ndaj vepra e saj jetësore gjithnjë na mbushë zemrat me krenari e frymëzim.

Përkushtimi i Nënë Terezës për më të varfrit, besimi i saj i palëkundur dhe dashuria për njerëzit, pavarësisht nga prejardhja e tyre, duhet të jenë udhërrëfyes për një botë më humane", ka thënë Osmani.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se 27 vjet më parë pushoi së rrahuri zemra e madhe e Nënë Terezës, humanistes së njohur dhe gruas së jashtëzakonshme, që ndryshoi botën për të mirë duke shtrirë dorën e ndihmës dhe kujdesit për të varfrit e të uriturit. "Jeta dhe vepra e saj është burim frymëzimi për secilin për t'u angazhuar për solidaritet,



harmoni dhe paqe mes nesh. Shën Tereza ishte dritë shprese për të dobëtit dhe shembull i përvullësisë, humanizmit e vetëmohimit. Prandaj, çdo shqiptar sot e përherë krenohet me të!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, e njohur si Nënë Tereza, lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe vdiq më 5 shtator 1997 në Kalkuta (Indi). Ishte humaniste e njohur shqiptare, fituese e çmimit Nobel për Paqe. Një figurë e diskutueshme si gjatë jetës dhe pas vdekjes së saj, Nënë Tereza u admirua gjerësisht nga shumë njerëz për veprat bamirëse.

Lajçaku më 6 shtator viziton Kosovën

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, të premtën, më 6 shtator, pritet ta vizitojë Kosovën, mëson "Radio Evropa e Lirë" nga burimet në Bruksel. Kjo vizitë, siç ka deklaruar vetë

Lajçaku javën e kaluar, ka për qëllim përgatitjen e një takimi në nivel kryenegociatorësh në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kësaj radhe, sipas burimeve, Lajçaku pas Prishtinës nuk do ta vizitojë Beogradin. Javën e kaluar, gjatë pjesëmarrjes në forumin për siguri, Globsec,

emisari evropian u takua me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Pragë.

Ndërkaq, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka përsëritur thirrjet ndaj autoriteteve të Kosovës që të përmbahen nga hapat e njëanshëm dhe të pakoordinuar që, sipas bllokut, mund t'i rrisin

tensionet në veri të vendit.

BE-ja, por edhe Shtetet e Bashkuara, Franca, Britania dhe Gjermania, e kanë kritikuar Kosovën për, siç kanë thënë, veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara në veriun e banuar me shumicë serbe. Këto kritika janë bërë pasi më 30 gusht Kosova



mbylli pesë institucione që funksiononin sipas sistemit serb.



MINISTRJA E PUNËVE TË JASHTME E FINLANDËS, ELINA VALTONEN, VJEN PËR VIZITË NË KOSOVË

Valtonen: Finlanda e gatshme ta ndihmojë Kosovën për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë

Ministrja e Punëve të Jashtme e Finlandës, Elina Valtonen, ka theksuar të enjten në Prishtinë, se shteti që ajo përfaqëson është i gatshëm të bëjë “çfarëdo që është e mundur” për ta mbështetur Kosovën në rrugën për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Valtonen ka thënë se Finlanda është pajtuar me marrëveshjen që kanë arritur palët vitin e kaluar. Ndërkaq përfaqësuesit e Kosovës e kanë falënderuar për mbështetjen që shteti i saj ka dhënë për Kosovën në çdo etapë

pastër. Kemi biseduar për dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe normalizimin e marrëdhënieve mes palëve. Finlanda është përkrahëse, në kuadër të KFOR-it dhe EULEX-it për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Ashtu siç është pajtuar në marrëveshjen e vitit të kaluar për normalizimin e marrëdhënieve, Finlanda është e gatshme të bëjë çfarëdo që është e mundur që t’ju mbështesë në këtë rrugë”, ka thënë Valtonen. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se temë diskutimi me homologen finlandeze ka qenë siguria në veri të vendit, ndërsa ka insistuar që ura mbi lumin Ibër duhet të hapet. Në një konferencë për medie, Gërvalla ka thënë se kjo urë ka simbolizuar ndarje dhe përçarje, ndërsa ka theksuar se Kosova është e përkushtuar ta zbatojë sundimin e ligjit në çdo cep të territorit të saj. “Kemi diskutuar edhe për sigurinë në veri të vendit, në veçanti për situatën e urës kryesore në Mitrovicë. Kjo urë, e cila ka simbolizuar ndarje dhe përçarje për shumë vjet, duhet të hapet. Vetëm kështu ajo shndërrohet në një simbol të pajtimit dhe bashkimit. Kosova është e përkushtuar ta zbatojë sundimin e ligjit në çdo cep të territorit të saj, duke garantuar të drejta të

barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht prej përkatësive të tyre etnike”, ka thënë Gërvalla, duke shtuar se kanë biseduar edhe për sfidat e sigurisë në Evropë. Gërvalla shprehet se anëtarësimi i Kosovës në NATO të bëhet në mënyrë të shpejtë, siç ndodhi me Finlandën. “Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve tona sot u përqendrua mbi sfidat aktuale të sigurisë në Evropë dhe agresionin rus kundër Ukrainës. Sjellja agresive dhe hegjemoniste e fqinjëve dhe aleatëve në Evropë paraqet një kërcënim të madh dhe serioz për paqen dhe stabilitetin evropian. Ne në Kosovë e kuptojmë më mirë se kushdo tjetër ndoshta rëndësinë e mbrojtjes së vlerave demokratike dhe të drejtës për vetëvendosje”, u shpreh ajo. Rolin e NATO-s Gërvalla e ka konsideruar jetik për stabilitetin e rajonit perëndimor. “Kosova qëndron fuqishëm në mbështetje të Ukrainës në këtë luftë për liri dhe sovranitet. Për më tepër, roli i NATO-s vazhdon të jetë jetik për stabilitetin e rajonit tonë. Ne jemi të përkushtuar t’i forcojmë marrëdhëniet tona me NATO-n. Synimi i Kosovës është anëtarësimi i plotë në NATO dhe mbetet një objektiv strategjik. Përvoja e Finlandës, që së fundmi u bë anëtare e kësaj aleançe, na shërben si një shembull që ne e

ndjekim dhe kemi shumë vëmendje”, ka thënë Gërvalla.

Osmani dhe Kurti takojnë Valtonen: Kosova dhe Finlanda janë partnere të palëkundura

Edhe presidentja Vjosa Osmani ka takuar të enjten në Prishtinë ministren e Punëve të Jashtme të Finlandës, Elina Valtonen. Osmani në “Facebook” ka shkruar se Kosova dhe Finlanda do ta vazhdojnë angazhimin për forcimin e raporteve ndërshtetërore. “Në mbrojtjen e vlerave evropiane, Kosova dhe Finlanda janë partnere të palëkundura! Në takim me ministren e Jashtme të Finlandës, Elina Valtonen, e falënderova për mbështetjen e shtetit të saj për Kosovën në çdo etapë, përfshirë procesin e shtetformimit, shtetëndërtimit dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Do të vazhdojmë angazhimin për forcimin e raporteve tona ndërshtetërore”, ka shkruar Osmani. Ministrja e Punëve të Jashtme e Finlandës, Elina Valtonen, është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 5 shtator - Ministrja e Punëve të Jashtme e Finlandës, Elina Valtonen, ka thënë se shteti i saj është i gatshëm të bëjë “çfarëdo që është e mundur” për ta mbështetur Kosovën në dialogun me Serbinë dhe normalizimin e marrëdhënieve. Valtonen në një konferencë të përbashkët për medie me ministren e Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, në Prishtinë, e ka quajtur Finlandën mike të fuqishme të Kosovës, e cila ka mbështetur anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO. Pas takimit të përbashkët, kryediplomatja finlandeze ka thënë se janë të gatshëm të

punojnë edhe në raportet tregtare, veçanërisht në digitalizim dhe energjinë e pastër, me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. “Finlanda ka qenë dhe mbetet mike e fuqishme e Kosovës. Kjo është theksuar mjaft në takimin e sotëm. Si mbështetje e fuqishme për Kosovën, ka qenë që nga koha kur ajo e ka fituar pavarësinë e saj. E kemi mbështetur anëtarësimin e Kosovës në BE, po ashtu mbështesim anëtarësimin e saj në NATO. Të gjithë anëtarët e Ballkanit Perëndimor janë të rëndësishëm. Ne jemi të gatshëm të punojmë intensivisht për t’i shtuar raportet tona tregtare dhe për t’i forcuar sektorët premtues, si digitalizimin dhe energjinë e

Lista Serbe: Institucionet paralele nuk e kanë shkelur ligjin

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Përfaqësues të Listës Serbe mbajtën më 5 shtator një konferencë të jashtëzakonshme për medie lidhur me ftesën që kanë marrë nga autoritetet e Kosovës për intervistim. Nga kjo parti, thanë se do t'i përgjigjen pozitivisht kësaj ftese.

Autoritetet e Kosovës kanë konfirmuar se do të intervistohen pesë persona nga pesë institucionet paralele serbe që u mbyllën në fund të gushtit. Personave që u janë dërguar këto thirrje për intervistim janë zyrtarë të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit.

Në konferencën për medie, Igor Simiq, duke folur në emër të personave që kanë marrë këto ftesa për intervistim, tha se ato i shohin si "përndjekje politike" jo vetëm të individëve që kanë udhëhequr institucionet paralele, të cilët janë ftuar për intervistim.

Ai tha se ky vendim është "persekutim i popullit serb" pasi, sipas tij, institucionet e mbyllura ofronin shërbime për qytetarët. "Nuk është çështja se si do të veprojnë nesër Igor Simiqi, Ivan Zaporozhiani, por si do t'ia bëjnë njerëzit të cilëve u shërbyen sa ishim në krye [të



institucioneve paralele]. Sa i përket këtyre institucioneve, autoritetet e Kosovës gjithmonë e kanë ditur ekzistencën e tyre. Nuk është asgjë e re që këto institucione kanë ekzistuar në këtë qytet dhe për to është diskutuar në nivel ndërkombëtar, dhe është negociuar në Bruksel se si do të funksionojnë këto institucione në të ardhmen", tha Simiq. Më 30 gusht autoritetet e Kosovës mbyllën pesë

institucione paralele serbe në veri të Kosovës, që kanë funksionuar sipas sistemit të Serbisë.

Sipas zyrtarëve shtetërorë në Kosovë, ato institucione kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjet e Republikës së Kosovës". Institucionet e mbyllura më 30 gusht ishin: Qarku i Mitrovicës së Kosovës, Komuna paralele e Mitrovicës, Komuna paralele e Zveçanit, Komuna paralele e Zubin Potokut dhe Komuna

paralele e Leposaviqit.

Simiq tha se këto institucione kanë ofruar shërbime juridike për të gjithë qytetarët dhe "nuk kanë shkelur asnjë ligj".

Gjatë konferencës, Simiq, që më herët kishte qenë deputet i Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës, foli edhe për çështjen e hapjes së urës kryesore mbi lumin Ibër për qarkullim të automjeteve.

Qeveria e Kosovës ka shprehur synimin që kjo urë të hapet, por

ka hasur në kundërshtimin e ndërkombëtarëve të cilët kanë argumentuar se për shkaqe sigurie, ura nuk duhet të hapet tani.

Simiq tha ky është momenti që "bashkësia ndërkombëtare ta tregojë fytyrën e saj". "Do të shohim nëse do të bëjnë ndonjë gjë", shtoi ai.

Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania kanë kritikuar aksionin e Policisë së Kosovës për mbylljen e institucioneve serbe. Përfundimi e ka cilësuar këtë si veprim të njëanshëm të institucioneve të Kosovës.

Në Kosovë, ka komuna, kompani dhe ndërmarrje publike, çerdhe, shkolla fillore, të mesme dhe universitete publike që financohen drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë, të cilat gjenden në qytetet dhe vendbanimet ku jeton komuniteti serb.

Këto institucione, sipas ligjeve në Kosovë, janë ilegale.

Më 2013 Kosova dhe Serbia në dialogun për normalizimin e raporteve në Bruksel kishin arritur një marrëveshje për shuarjen e institucioneve paralele, por ende kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht. (rel)

MPJD u bënë thirrje shtetasve të Kosovës dhe mërgatës t'i shmangin pikat kufitare me Serbinë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD) u ka bërë thirrje të mërkurën vonë shtetasve të Kosovës dhe mërgatës së Kosovës t'i shmangin pikëkalimet kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë gjatë udhëtimit të tyre transit, për shkak të, siç ka bërë me dije, paralajmërimeve për bllokimin e rrugëve në Serbi që çojnë drejt vendkalimeve kufitare këtë javë. Në Facebook, MPJD tha se një i "ashtuquajtur 'Këshill Organizativ për Bllokada' në Serbi" ka njoftuar se më 6 shtator ka ndër mend t'i bllokojë rrugët që çojnë drejt vendkalimeve kufitare me Kosovën. Ajo u kërkoi "të gjithë qytetarëve dhe pjesëtarëve të mërgatës që t'i ndjekin me kujdes zhvillimet dhe paralajmërimet e reja lidhur me situatën dhe të informohen vetëm nga burimet zyrtare të institucioneve të Kosovës për t'i shmangur dezinformatat dhe lajmet e rreme".

Ky njoftim vjen në një kohë kur autoritetet e Kosovës e kanë zemëruar Serbinë me një sërë



veprimesh që i kanë ndërmarrë në veri të vendit - pjesë e banuar me shumicë serbe duke nxitur edhe kritika nga bashkësia ndërkombëtare.

Javën e kaluar qeveria e kryeministrit Albin Kurti i mbylli

pesë institucione paralele serbe në katër komunat me shumicë serbe, për të cilat tha se vepronin në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e vendit. Në disa nga objektet që më herët janë përdorur nga

institucionet paralele, ditët e fundit janë vendosur pllaka që tregojnë se tani ato do të përdoren si zyra për disa nga ministritë e Kosovës dhe departamentet e tyre.

Punëtorët e atyre institucioneve

paralele kanë protestuar dy ditë kundër mbylljes së tyre. Policia e Kosovës konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se të mërkurën intervistoi pesë persona të lidhur me këto institucione paralele.

Mbylljes së këtyre institucioneve paralele i parapriu ndalimi i dinarit serb dhe mbyllja e disa degëve të Postës së Serbisë në veri më herët këtë vit.

Qeveria e Kosovës ka thënë vazhdimisht se po përpiqet të vendosë rend dhe ligj në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe duke i shuar institucionet paralele serbe.

Vendimet e qeverisë së Kurtit janë kritikuar ashpër si të "njëanshme dhe të pakoordinuara" nga bashkësia ndërkombëtare, e cila ka thënë se ato rrezikojnë rritjen e tensioneve.

Më 2022 serbët në veri i bllokuan rrugët drejt pikave kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë pas arrestimit të një ish-policit serb të Policisë së Kosovës. Ato ishin hequr pas disa javësh.

Latifi uron Mundon për detyrën e re në KFOR, diskutojnë për sigurinë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it italian për Rajonin Perëndim, kolonel Rocco Mundo, me bashkëpunëtorët e tij dhe përfaqësuesit e LMT-së në

Rahovec. Kryetari Latifi e ka uruar Mundon për detyrën e re dhe kanë diskutuar për sigurinë dhe për forcimin e bashkëpunimit, edhe për përkrahjen në projekte për qytetarët. "Falënderova kolonelin Mundo për

angazhimin në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në Kosovë. Komuna e Rahovecit është e hapur për komunikim dhe për bashkëpunim për sigurinë dhe të mirën e përgjithshme", ka thënë Latifi.



Hamza pret në takim ambasadorin francez: Rruga jonë, drejt vizionit euroatlantik



MITROVICË, 5 SHTATOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka bashkëbiseduar në Mitrovicë me ambasadorin e Francës, Olivier Guerot. Gjatë këtij takimi u diskutua për nevojën e rritjes së bashkëpunimit në çështjet me interes dypalësh, por edhe në interes të forcimit të paqes, bashkëjetesës dhe sigurisë në Kosovë e rajon. Hamza ka theksuar se Franca është partner strategjike e Kosovës për forcimin e perspektivës euroatlantike dhe zhvillimit ekonomik. "Si mike e

dëshmuar, ajo na ka mbështetur në të gjitha proceset jetike për vendin dhe është adresë shumë e rëndësishme për integrimin e shteteve që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian", ka thënë Hamza. Ai ka shtuar se Kosova është mirënjohëse ndaj Francës dhe partnerëve strategjikë përëndimorë. "Unë besoj se në rrugën tonë drejt realizimit të vizionit euroatlantik duhet të ecim së bashku me të gjitha shtetet partnere përëndimore", është shprehur Hamza.

250 fëmijë me asistencë sociale në Gjilan pajisen me çanta dhe materiale shkollore



GJILAN, 5 SHTATOR - Nxënësit me kushte jo të mira materiale janë furnizuar me çanta dhe materiale të tjera për ta vazhduar mësimin. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se po vazhdon mbështetja për 250

fëmijë nga familjet me asistencë sociale, të cilët po pajisen me çanta dhe materiale shkollore. Ai ka thënë se këta nxënës janë nga klasa e parë deri në të pestën. "U urojmë të gjithë nxënësve një vit të mbarë dhe të suksesshëm shkollor", tha

Hyseni. I pari i komunës falënderoi organizatën Islamic Relief Kosova për bashkëfinancimin e këtij projekti, e cila ka kontribuar që të shohim kaq shumë buzëqeshje në fytyrat e këtyre fëmijëve sot.

Transport publik falas për qytetarët e Kamenicës për 20 ditë

KAMENICË, 5 SHTATOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me stafin e tij, kanë bërë xhiron e parë me autobusin i cili është bashkëpunim me FES (Friedrich Ebert Stiftung). I pari i Kamenicës ka theksuar se janë duke rishikuar mundësinë për transport publik të rregullt në Kamenicë. "Drejt

transportit publik. E kemi bërë xhiron e parë sot me autobusin që do të jetë në lëvizje për 20 ditë. Transport publik falas për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Po studiojmë mundësitë për transport publik të rregullt në Kamenicë. Faleminderit Friedrich Ebert Stiftung, Prishtina Office", ka thënë Rahimaj.



Edhe një objekt i rëndësishëm në kryeqytet kyçet në "Termokos"

PRISHTINË, 5 SHTATOR - "Shtëpia e Pavarësisë Dr. Ibrahim Rugova" ka filluar të kyçet në "Termokos". Kryetari i Prishtinës, Përparim

Rama, ka thënë se tashmë kanë filluar punimet për kyçjen në sistemin e ngrohjes qendrore të "Termokos"-it, në objektin-muze, me peshë të

madhe për secilin prej nesh. "Kjo do të sigurojë ngrohje të qëndrueshme dhe efikase për këtë objekt historik, duke respektuar trashëgiminë

kombëtare dhe ofruar komoditet për vizitorët. "Termokos" po i jep kuptim Prishtinës së gjelbër", ka thënë Rama.



Shtatorja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe Sindromi i Fregolit

Bardhyl MAHMUTI,
politolog

Në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për kontributin e gjithanshëm të arbëreshëve të Italisë dhe sidomos për solidaritetin e pashembullt që treguan duke hapur dyert e shtëpive dhe zemrat bujare për shqiptarët e dëbuar gjatë zbatimit të gjenocidit të Serbisë në luftën e viteve 1998-1999, në shtator të vitit 2023, Shoqata "Hora e Skënderbeut" ndërmori nismën, që në emër të mërgimtarëve shqiptarë t'u dhurojë atyre shtatoren e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Meqenëse Hora e Arbëreshëvet (Fshati i Arbëreshëvet), që sot njihet si Piana degli Albanesi, është një nga vendbanimet më të hershme të arbëreshëve në Itali, që është themeluar në 20-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit, në vitin 1488, Kryesia e Shoqatës "Hora e Skënderbeut" dhe autoritetet e Bashkisë Hora e Arbëreshëvet kishin vendosur që inaugurimi i shtatores të bëhej në ditën e kremtimit të themelimit të këtij vendbanimi arbëresh.

Publikimi i pamjes së shtatores madhështore (mbi tre metra e lartë), e punuar me mjeshhtëri nga skulptori Gëzim Muriqi, entuziazmoi një numër të konsiderueshëm shqiptarësh nga të katërta anët e botës, të cilët e përkrahën financiarisht realizimin e kësaj veprë me vlera të mëdha artistike.

Përgjatë një viti të plotë sa ishte publik projekti i kësaj shtatores, asnjë kritik arti nuk bëri asnjë vërejtje rreth risive që sillte skulptori Gëzim Muriqi në pamjen e figurës emblematike kombëtare të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Kryetari i Bashkisë Hora e Arbëreshëvet, Rosario Petta, dhe autoritetet e tjera bashkiake organizuan darkën e mirëseardhjes për qindra mysafirë që kishin ardhur nga Australia, SHBA-ja, Kanadaja, shtetet skandinave, shtete të ndryshme të Europës Perëndimore, Shqipëria, Kosova, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut dhe Mal i Zi. Përveç autoriteteve bashkiake, një mikpritje të jashtëzakonshme na ofruan edhe arbëreshët kudo që shkonim. Të ngazëllyer nga madhështia e shtatores, arbëreshët vendas dhe ata që kishin ardhur nga vendbanime të tjera arbëreshe të Italisë, i puthnin duart mjeshtrit të madh, Gëzim Muriqit, dhe e bekonin pandërprerë për këtë veprë të mrekullueshme artistike.

Sulmet politike që pasuan pas inaugurimit të shtatores, më detyruan të rikujtoj disa momente madhështore që na shoqëruan gjatë qëndrimit

disaditësh në Horën e Arbëreshëvet! Shqiptarët si shqiptarë gjatë gjithë kohës këndonin, vallëzonin, kuvendonin, drekonin dhe darkonin dhe të gjithë kishin lënë në shtëpitë e tyre petkun partiak, ideologjik dhe fetar! Në tavolinën tonë ku këndonin me çifteli Enver Dugolli dhe Agim Morina askush nuk e shihte askënd si përfaqësues të VV-së, PDK-së, LDK-së, AAK-së, Nismës Socialdemokrate, Partisë Socialiste, Partisë Demokratike; askush nuk e interpretoi praninë e ministrave, deputetëve dhe politikanëve nga Kosova si prani në funksion të qëllimeve politike; askush nuk shihte askënd si drenicak, dukagjin, llapjan, shaljan, tetovar, preshevar, strugan, dibran, shkodran, tيرانas, malësorë të Nikaj-Mërturit të Tropojës etj. Aty të gjithë kishin ardhur si shqiptarë, që i kishte bashkuar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu!

Duke u nisur nga fakti se, përveç ftesave zyrtare drejtuar funksionarëve të institucioneve shtetërore shqiptare në Ballkan, që kishte bërë nikoqiri i përrurimit të shtatores, kishte ftesë publike nga ana e Bashkisë Hora e Arbëreshëvet dhe e Shoqatës "Hora e Skënderbeut", që u drejtohej të gjithë shqiptarëve pa dallime politike, ideologjike, fetare apo shteteve ku jetojnë. Ndaj nuk ma merrte mendja, se prania në këtë inaugurim e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Elisa Spiropoli, do të nxiste reagime, që kanë për qëllim të përdhosin veprën e mrekullueshme artistike të Gëzim Muriqit!

Në funksion të manipulimit me njerëzit e verbuar nga këndvështrimi ideologjik, autorë perversë sajuan një montazh, që i mvesh figurës së skulpturës të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut tiparet e fytyrës së Edi Ramës! Programe të ndryshme të teknologjisë informatike mundësojnë që edhe gomarit të Nasradin Hoxhës apo Kalit të Trojës t'i japim tiparet e cilido politikani. Madje nuk duhet përyshuar mundësia, që me manipulime të kësaj natyre të shohim shpërndarjen në rrjetet sociale të Gjergj Kastriotit të skulpturuar nga Gëzim Muriqi mbi kalin e Skënderbeut me tipare të fytyrës së ndonjë politikani shqiptar! Por manipulime të kësaj natyre nuk mund të përdhosin vlerat e pakontestueshme të veprës artistike të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, të realizuar mjeshhtërisht nga Gëzim Muriqi! Të shohësh në skulpturën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, të realizuar nga Gëzim Muriqi, tipare të fytyrës së Edi Ramës nuk është asgjë tjetër, përveçse shfaqje e Sindromit të Fregolit. Po sqaroj për lexuesit që nuk



kanë njohuri për këtë sindrom, se është një çrregullim mendor, që manifestohet te pacienti si bindje se një person prej tij është transformuar nga paraqitja fizike veç për ta persekutuar atë. Pacientët "e rëndomtë" besojnë se persekutori është ndonjë person i afërm i tyre, kurse për "politikanët" e goditur nga ky sindrom, kundërshtari i tyre politik është persekutori që ndërton zërin, veshjen, madje edhe materien në veprat artistike, për të krijuar një aparençë tjetër, siç bënte me një shpejtësisë të jashtëzakonshme në skenën e teatrit aktori italian, Leopardo Fregoli, prej të cilit ka marrë emrin edhe ky sindrom. Doktorit e di se Sindromi i Fregolit prek personat e sëmurë nga skizofrenia, epilepsia ose demenca. E vetmja mënyrë për të ndihmuar pacientin e prekur nga Sindromi i Fregolit është mosaderimi në botën e tij paranojake. Në të kundërtën, aderimi në botën e tij, sa për t'ia bërë qejfin, rrezikon tërë rrethin e tij të preket nga ky sindrom. Ndaj të gjithë ata që shohin në skulpturën e Skënderbeut të artistit Muriqi tipare të Edi Ramës janë të prekur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga ky çrregullim mendor.

Të goditurit nga ky sindrom nuk mjaftojnë me kaq. Përveç manipulimit të lartpërmendur me teknologjinë informatike, dhelparakëve të verbuarve ideologjikisht u duket si lëkurë dhelpre lëkura e ujkut mbi shpatullën e shtatit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Prania e simbolit të ujkut në lëkurë të rrjepur në shtatoren e skulpturuar nga Gëzim Muriqi

përbën një ndër elementet, që paraqesin origjinalitetin e prezantimit artistik të figurës emblematike kombëtare të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut! Një qasje interesante dhe të saktë rreth aspektit historik dhe kulturor të simbolikës së ujkut në antikitet ka bërë kritiku i artit, Ilir Muharremi. Mirëpo që të kuptohet në plotni domethënia e një simboli, ai duhet të shihet në kontekstin e kohës së cilës i referohet artisti.

Në këtë kontekst po përmend dy gjëra:

Së pari, po theksoj se në Mesjetë, nën ndikimin e Kishës, simboli i ujkut humbi të gjitha cilësitë pozitive që ia kishin atribuuar shoqëritë e ndryshme gjatë antikitetit dhe u shndërrua në kafshën më të rrezikshme, me tipare të shumta negative. Në aspektin figurativ, ujkut përdorej si simbol, që kërcënonte vazhdimisht "grigjën e deleve", prandaj "barinjët" duhej të tërhiqnin vëmendjen e njerëzve, që të ishin më vigjilentë karshi rreziqeve nga ata që shtiren si "qengja"!

Së dyti, gjatë disa mijëvjeçarëve, malësorët shqiptarë, që merrshin kryesisht me blegtori, bartnin gëzofë nga lëkura deshësh!

Nëse kemi parasysh këto dy fakte, atëherë lëkura e ujkut në supet e shtatores së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut merr një simbolikë të veçantë: të gjithë ata që mund t'i marrin shqiptarët për dele e qengja, duhet ta dinë se do të ballafaqohen me atë, që mban mbi supe lëkurën e ujkut të rrjepur.

Ndërkaq, ata që kërkojnë qimen

në vezë, e dinë fare mirë se pelerina dhe veshja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në skulpturën e artistit Gëzim Muriqi nuk ka asgjë të përbashkët me vikingët, por është gjetje origjinale e artistit, sepse asgjë më mirë se pozita e palave të pelerinës në këtë skulpturë nuk mund të pasqyrojë furtunën, që i kanosej vazhdimisht atdheut tonë.

Prandaj pozita e Emblemës Kombëtare, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në gjendje gatishmërie, mbi shkëmbin e atdheut që mbart plagët e copëtuar, dhe të palëkundur përballë furtunave të kohës, që pasqyrojnë palat e pelerinës, u ngulit në shpirtin tonë si një kryevepër që do të mbijetojë ndër mijëvjeçarë!

P.S.

Gjatë dekadave të fundit, perceptimi shoqëror për ujkun ka ndryshuar dukshëm. Nuk përjashtohet mundësia që, me kalimin e kohës, të ndryshojë edhe simbolika e kësaj kafshe në veprat artistike.

Edhe perceptimi për dhelpprat ka ndryshuar. Sot vlerësohet aftësia e kësaj kafshe për të gjetur zgjidhje kreative për problemet që i dalin përpara dhe për t'u përshatur me rrethanat e reja. Sot ka ende disa zonja dhe zotërinj të bordeleve të natës, që, për të fshehur lakuriqësinë e tyre, vazhdojnë të mbajnë gëzofë me jakë nga lëkura e dhelpërës, dhe politikanë ballkanikë që veprojnë me sintagmën e moçme: kur dhelpërës i djeg bishti, le të digjet i gjithë katundi!

“Pastrimi” paralajmëron procedimin e borxheve te përmbaruesit

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kompania Regionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A. ka njoftuar se do ta bëjë procedimin e borxheve në procedurën përmbarimore te përmbaruesit privatë. “Procedimi i borxheve do të bëhet për klientët e amvisërisë, bizneseve dhe institucioneve përfshirë edhe institucionet publike të cilat kanë borxhe për faturat e

mbeturinave. Afati kohor i përmbarjes së obligimeve të klientëve për pagesë të faturës së mbeturinave është deri me dt. 06 Shtator 2024 ora 16:00”, thuhet në njoftimin për medie. Po ashtu, është bërë me dije se për të gjithë klientët kompania “Pastrimi” ofron mundësinë e marrëveshjes për riprogramim të borxheve me këste deri në 12 muaj. “Ju

bëjmë thirrje gjithë klientëve të kompanisë ‘Pastrimi’, SH.A që të përmbarin obligimet e tyre që kanë ndaj kompanisë sonë sepse në rast të mospagesës së obligimeve (borxheve), ju njoftojmë që borxhet e papaguara pas datës 6 shtator 2024 do të procedohen tek përmbaruesit privat”, thuhet në njoftimin e “Pastrimi”-it Sh. A.



“Vjelja e rrushit Kosova 2024” në Suharekë: Kosova ka nevojë për mbështetje të prodhimit

SUHAREKË, 5 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) dhe “Agro Kosova Holding” në Suharekë kanë mbajtur aktivitetin tradicional “Vjelja e rrushit Kosova 2024”.

Aktiviteti me moton: “Unë konsumoj produkte vendore, po ju?”, ka mbledhur kultivues të rrushit nga niveli lokal dhe përfaqësues të bizneseve vendore.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se tashmë ky është një event tradicional, me çrast i ka bërë thirrje qeverisë të fokusohet më shumë në përmirësimin e kushteve për investime të huaja dhe për prodhuesit vendorë. “Qëllimi i këtij aktiviteti është t’i promovojmë produktet e



Kosovës, t’i promovojmë prodhimet ‘Made in Kosova’, sepse ‘Agro Kosova Holding’ ka një asimetri të zgjeruara të prodhimeve agrare dhe finale duke përfshirë këtu rrush, qershi, dardhë, mollë e perime të ndryshme, por edhe si podrum i verës ‘Theranda’ e cila ka shumë produkte cilësore. Produktet e kësaj kompanie dhe prodhimet e Kosovës tashmë janë në tavolinat e Kosovës dhe në tërë Ballkanin dhe Evropën. Është një fakt i mirë që është një kompani e vetme që eksporton në disa vende të Ballkanit. Dhe është një nga importuesit më të mëdhenj të këtij produkti nga Kosova. Vendi ynë ka nevojë për mbështetje të prodhimit.

Shërbimet dhe prodhimet e Kosovës do të mund ta ngrehin cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës nëse qeveria do të krijojë hapësirë më të madhe për t’i mbështetur prodhuesit vendorë”, ka thënë Shahini.

Ndërsa pronari i “AgroKosova Holding”, Haziz Tafaj, ka bërë me dije se pavarësisht se ka qenë një vit i vështirë, kanë arritur të prodhojnë rrush të mirë dhe ruajnë traditën e zhvilluar nga gjeneratat.

Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka theksuar se komuna që udhëheq shquhet për prodhimtari dhe suksese në shumë fusha. “Jam i interesuar që bizneset e Suharekës të ecin përpara”, ka thënë ai.

“Trepça” eksporton 237 50 tonelata koncentrat të plumbit

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ndërmarrja “Trepça” ditë më parë ka njoftuar se si përgjigje ndaj situatës afariste, menaxhmenti po merr një sërë vendimesh për transferimin dhe sistemin e përkohshëm të punonjësve. Sipas tyre, me qëllim që ta rrisin prodhimin dhe t’i mbështesin operimet në dy njësitë biznesore të minierave me flotacion Trepça - Stan Tërg dhe Kishnicë - Artanë.

Kjo ndërmarrje të enjten në “Facebook” ka njoftuar se të mërkurën ka eksportuar



koncentratin e plumbit ‘K/Pb’ nga Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça në Stan Tërg. “Më 4.9.24 Ndërmarrja Trepça Sh.A. ka eksportuar koncentratin e plumbit ‘K/Pb’ nga Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça në Stan Tërg. Sasia e eksportuar e koncentratit të plumbit është 237.50T”, thuhet në njoftim. Ditë më parë u njoftua se deri tani gjashtë nëpunësve të menaxhmentit u janë caktuar detyra në njësitë biznesore të Ndërmarrjes Trepça, ndërsa janë bërë rreth 80 sistemime në

ecurinë e prodhimit në njësinë Trepça - Stan Tërg.

Lidhur me prodhimin në këtë ndërmarrje kishte shkruar edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. “Punëtorët e Trepçës në minierë e në flotacion janë duke punuar me përkushtim e kapacitet të shtuar për të rritur prodhimin e ashtu të hyrat e ndërmarrjes. Në anën tjetër, bordi dhe menaxhmenti i lartë i ndërmarrjes janë duke punuar me zell e me vigjilencë për forcim të kontrollit të brendshëm e rritje të disiplinës”, kishte thënë ajo.

Dogana parandalon një rast të kontrabandës së mallrave


PRISHTINË, 5 SHTATOR - Njësia e “Task Forcës” Lindje (e përberë nga Policia dhe Dogana e Kosovës), në zbatim të masave për parandalim dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë shtuar kontrollat taktike dhe operacionet në zonën kufitare RKS-SRB. “Me datë 05.09.2024 rreth orës 06:35 në brezin kufitar mes fshatit Dobrosinë SRB dhe fshatit Stublinë - RKS

është vërejtur një automjet VW Passat me targa serbe i cili dyshohet se ishte duke bërë kontrabandim me mallra. Automjeti i dyshuar është arrit të ndalet gjatë kontrollit dhe është vërejtur se drejtohej nga i dyshuari nga Bujanoci - SRB, i cili kishte pasur të ngarkuar disa thasë të najlonit të zi ku në brendësi kishte duhan me peshe nga 500 gramë gjithsej 340 kg. të llojeve të ndryshme

si: Malbooro slim, Malboro silver, Sobranie dhe Tabako. Vlera e mallit dhe shmangiet doganore janë rreth 20.000 euro”, ka njoftuar Dogana. Lidhur me rastin të gjitha veprimet janë ndërmarrë në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit. Malli i kontrabanduar dhe automjeti janë sekuestruar dhe dërguar në terminalin doganor Dheu i Bardhë.



Ka një shtëpi për njeriun në Hënë



Ka një shtëpi për njeriun në Hënë. Kështu mund të përmbledhim zbulimin e rëndësishëm të një grupi studiuesish, të udhëhequr nga Universiteti i Trentos, për ekzistencën e tuneleve në sipërfaqen hënore, të aftë për të vepruar si bazë e përhershme për misionet e ardhshme.

Këto janë struktura magjepsëse gjeologjike nëntokësore të njohura si “tuba lavë” që u formuan falë aktivitetit të lashtë vullkanik të satelitit tonë. Kur vullkanizmi i Hënës ishte intensiv, llava e lëngshme doli në sipërfaqe, rrodhi mbi të dhe u ngurtësua duke formuar një kore. Më poshtë, materiali vazhdoi të rrjedhë përmes një sërë kanalesh. Me kalimin e kohës, kur prurja e llavës zvogëlohej apo u ndal, llava brenda kanalit u largua, duke lënë pas “tuba” bosh nën sipërfaqen e ngurtësuar që formuan rrjete autentike nëntokësore.

Disa astronomë kishin hedhur teorinë e ekzistencës së këtyre tuneleve të paktën 50 vjet më parë, por kurrë nuk kishte pasur konsensus unanim mbi hipotezën. Tani, studiuesit e Trentos kanë qenë në gjendje ta konfirmojnë duke ekzaminuar skanimet e një grope të vendosur në rajonin Mare Tranquillitatis, të marra në vitin 2010 nga instrumenti miniaturë i frekuencave radio (Mini-RF) në bordin e Lunar Reconnaissance Orbiter i NASA-s.

Analiza e të dhënave lejoi gjithashtu të krijohet një model i një pjese të tubacionit. “Ajo që gjetëm është tuneli i vetëm që njohim. Por është hedhur për një kohë të gjatë hipoteza, se mund të

ketë shumë të tjerë dhe se ato mund të formojnë një lloj rrjeti nën sipërfaqen hënore”, thotë Lorenzo Bruzzone, profesor në Universitetin e Trentos, drejtor i Laboratorit të sensorëve në distancë dhe bashkë-autor i studimit të botuar në Nature Astronomy. “Në përgjithësi, ajo që mund të them është se në sipërfaqen e Hënës ka shumë hapje, apo puse, të ngjashme me ato që kemi studiuar. Mendohet se ato janë për shkak të shembjes së çatisë së tubave të zbrazura të lavës dhe për këtë arsye vazhdojnë përtej pjesës së hapur. Megjithatë, jo vetëm që nuk ka asnjë konfirmim, por nuk dihet as

nëse janë të aksesueshme, ato mund të bllokohen nga mbeturinat e shembjes. Është një hap më afër një misioni robotik për të eksploruar shpellën. Tani e dimë saktësisht se ku ta dërgojmë robotin për verifikim.” Fatkeqësisht, Mini-RF i NASA-s dha të dhëna vetëm për disa pjesë të Hënës, dhe niveli i tyre i kufizuar i detajeve (rezolucion gjeometrik) lejon të eksplorohej vetëm puse shumë të mëdha. “Për më tepër, për të bërë një model të hyrjes në një tunel, duhet të verifikohen kushte të veçanta në lidhje me gjeometrinë e boshtit dhe marrjen e radarit. Kjo kufizon mundësinë për të


ditur më shumë për galeritë e tjera që sigurisht janë të pranishme”, përfundon Bruzzone. Ky zbulim mund të fusë një dozë të mirë optimizmi në lidhje me skenarët e mundshëm të ardhshëm të njeriut në Hënë. Deri më tani, planet për praninë njerëzore ishin fokusuar në krijimin e një baze operacionale në sipërfaqe, me të gjitha disavantazhet për banorët e ardhshëm të saj. Sateliti ynë është një mjedis jashtëzakonisht armiqësor, edhe për vetë instrumentet që përdor njeriu. Temperatura e tij është mesatarisht -23 gradë Celsius, por në sipërfaqe mund të ndryshojë

nga -247 në Polin e Veriut në 127 në zonat e ekuatorit ku shkëlqen dielli.

Por nuk është vetëm kjo. Bombardimet e rrezatimit diellor dhe kozmik janë deri 150 herë më të forta se ato të përjetuara në Tokë, dhe përplasjet e meteorëve janë më të shpeshta. Aftësia për të përdorur tubat e lavës do të thotë siguri e nevojshme për këdo që kërkon një qëndrim të zgjatur në Hënë.

Nëso do të mund të kishte qindra puse dhe mijëra tuba të llavës, vende të tilla mund të veprojnë si një strehë natyrore për astronautët, duke i mbrojtur ata nga rrezet kozmike, rrezatimi diellor dhe meteorët. Ndërtimi i habitatit nga e para është më i kushtueshëm për sa i përket kohës dhe burimeve, sepse do të ishte i nevojshëm përforcimi i mureve të shpellës për të shmangur një shembje dhe instalim i “ashensorëve” për t’u ulur dhe për të dalë.

Ndër të tjera, rrjetet nëntokësore mund të përdoren për të nxjerrë burime të vlefshme hënore si metale dhe madje edhe rezerva akulli. Kjo do të reduktonte në mënyrë drastike kostot dhe logistikën e transportit të materialeve nga Toka. Shpella e sapo zbuluar mund të shihet në modele kompjuterike. Një krahasim i mirë në Tokë është ai vullkanik nëntokësor në ishullin Lanzarote, Spanjë. Dhe ka vend edhe për imagjinatë, e cila nuk mund të mos fillojë nga një vëzhgim me sy të lirë i Mare Tranquillitatis, ku ndodhet pusi: një pellg në hemisferën hënore gjithmonë përballë Tokës. / bota.al



Furtuna, fundosje dhe spiunazh kibernetik: “Menyja” e komplotit është gati



Një jaht luksoz, Bayesian që u mbyt më 19 gusht disa qindra metra larg portit të Palermos. Deri këtu, nuk do të kishte asgjë të jashtëzakonshme.

Gjërat ndryshojnë sapo mësohet identiteti i personave në bord dhe, për fat të keq, viktimave. Ndër këta, më famshmi është padyshim manjati britanik Mike Lynch.

Një aksident rrugor në Angli, në rajonin e Cambridgeshire: një këmbësor u godit me makinë më 17 gusht dhe vdiq dy ditë më vonë. Sërish, asgjë e jashtëzakonshme, nëse nuk do të ishte për identitetin e viktimës: Stephen Chamberlain, partneri i Lynch.

Ajo që bashkon dy tragjedi të largëta gjeografikisht dhe ngjyros me të verdhë të gjithë historisë është marrëdhënia që lidhte dy viktimat: Lynch dhe Chamberlain ishin partnerë biznesi. Së bashku ata kishin themeluar dy kompani: Darktrace dhe Autonomy. Realitete aktive në botën e sigurisë kibernetike, më konkretisht spiunazhit kibernetik. Dhe menyja e komplotit “u shërbye”. Që në orët e para të 20 gushtit, kur

filloi të përhapej lajmi për mbytjen e anijes, nisën akuzat: nuk mund të jetë rastësi që menjëherë pasi u lirua nga akuza për mashtrim (për shitjen e Autonomy) Lynch vdiq. Praktikisht në të njëjtën kohë me partnerin e tij Chamberlain. Në Palermo u zhduk edhe avokati i Lynch, Chris Morvillo.

U fol për trafikë të errëta të viktimave të dy aksidenteve. Të cilët, megjithatë, sapo vinin nga një fitore gjyqësore: “Pesëmbëdhjetë të mbijetuarit e anijes Bayesian, përfshirë Angela Bacares, gruan e Lynch, konfirmuan se festa me varkë ishte organizuar për të festuar lirin e plotë të Lynch dhe Chamberlain, të cilët në qershor u liruan të dy nga akuzat për mashtrim dhe llogari të rreme nga gjykata e San Franciskos”.

Në të vërtetë, diku shkruhej madje se ndonjë shërbim sekret i pamundura mund ta ketë goditur Bayesianin me një vorbull të targetuar. E parashikueshme, ndoshta edhe e natyrshme. Kur ka marrëdhënie me shërbimet sekrete (Darktrace është një mjet

jashtëzakonisht i avancuar që përdor një sistem të inteligjencës artificiale i cili mëson vetë), porosi miliarda dollarëshe me Pentagonin, marrëveshje me CIA dhe NSA, një aksident rrugor dhe një mbytje anije, të zhytesh në teoritë e konspiracionit është mënyra më e thjeshtë, është ajo që jep përgjigjet më të menjëhershme. Sepse ato, teoritë e komplotit pra, ofrojnë rregull aty ku ka veç ngatërresa. Dhe kaos.

Megjithatë, ka një gjë që duhet marrë parasysh: rasti ekziston. Dhe ne duhet të merremi me të. Le të supozojmë gjithashtu, që një aksident rrugor si ai në të cilin mbeti viktimë Chamberlain, mund të organizohet me lehtësi relative. Por e njëjta gjë nuk mund të thuhet për mbytjen e një anijeje që përfshin 22 persona, e cila gjithashtu ndodhi gjatë një stuhie. Shkaku i të cilës duket se lidhet, siç kujton klimatologu Paolo Sottocorona, me gjendjen problematike në të cilën ndodhet Deti Mesdhe, i tropikalizuar gjithnjë e më shumë për shkak të ngrohjes globale: “Deti i ngrohtë duket i këndshëm, por nxehtësia

nga pikëpamja fizike është energji. Mesdheu për momentin është një depozitë benzine. Po të vendosësh një shkrepëse aty, pra një rrymë ajri të ftohtë si ato të këtyre ditëve, shpërthen”, thoshte Sottocorona për La Repubblica. Sigurisht, sapo u shfaqën marrëdhëniet e Lynch me shërbimet e fshehta, kujtesa kolektive u zhvendos në mënyrë të pashmangshme tek një tjetër anije të mbytur: ajo e 28 majit 2023, kur në liqenin Maggiore u fundos një varkë plot me agentë Aise dhe Mossad, së bashku me të gjitha sekretet e atij takimi të pazakontë. Edhe në atë rast një përkeqësim i papritur i kushteve atmosferike.

Edhe nëse shumë rastësi mund të duken befasuese apo edhe shqetësuese, është gjithmonë mirë që të analizohen faktet në bazë të elementeve që kemi në dispozicion: ekziston një video e qartë e momentit të fundosjes së Bayesian-it, i “gëlltitur” nga dallgët në më pak se një minutë, ku nuk duket se shfaqen elementë të palëve të treta, që sugjerojnë

sabotim; duhet analizuar mundësia që zona të tilla si porti i Palermos, qyteti i pestë italian për nga popullsia, mund të jenë shkelur nga ata që me sa duket donin të ndërhyjnë ose të organizonin një formë sabotimi ose ndërhyrjeje të jashtme. Dikush mund të pyesë veten nëse ata që donin të mbyllnin gojën e Lynch-it për të zgjidhur sekretet e paspecifikuara ose llogaritë personale, nuk do kishin menduar për një metodë më pak të dukshme.

Së fundi, ekziston dilema e vjetër “kush përfiton?”, duke qenë se figura e viktimës më të diskutuar të mbytjes u ngrit në sytë tanë, bashkë me ngarkesën e mistereve që e rrethuan pas vdekjes së tij. Si përfundim, le ta lëmë hetimin të ecë, përpara se të hidhemi në përfundime të lehta. Nëse do të donim të kënaqeshim me një majë të teorisë konspirative, le të themi se nëse do të ishim 007, këto ditë do të shmangnim çdo ftesë për të marrë pjesë në një udhëtim me varkë. Por kjo është një histori tjetër.

Inside Over – Bota.al

Lëndimi prej padrejtësisë



Nga mosha 4 deri në 6 vjeç, kur fëmija fillon të kuptojë se është një individ me karakteristikat e veta, mund të ndodhë zgjimi i kësaj plaje. Ajo shkaktohet nga prindër shumë kërkues, të cilët mund të kërkojnë më shumë sesa mund të japë ose të përballojë një fëmijë. Të mos qenit në gjendje të shprehësh përjetohet me një ndjesi padrejtësie, veçanërisht ndaj prindit të të njëjtit seks. Fëmija vuan nga kritikën që merr, ashpërsia, intoleranca ndaj tij, ftohtësia dhe përshtatja me disa rregulla të sjelljes që kërkon prindi.

Për të shmangur vuajtjet, ai ndalon së perceptuari atë që ndjen, fillon të krijojë një maskë ngurtësie, duke u përpjekur të mos ndjejë atë që ndjen dhe gjithashtu të mos ua tregojë të tjerëve. Ai fillon kështu të shfaqet i ftohtë dhe i pandjeshëm, të kërkojë saktësi dhe drejtësi në çdo gjë, duke u bërë perfeksionist për t'u ndjerë "i drejtë". Që në moshë të vogël në fakt ka vënë re se vlerësohet për atë që bën më shumë se për atë që është, ndaj bëhet efikas dhe preciz, duke shfaqur pozitivitet dhe optimizëm, për të mos ndjerë vuajtje.

Të jetosh në pakënaqësi

Prandaj, emocionet që personi

ndjen më shpesh është zemërimi, veçanërisht ndaj vetvetes, edhe nëse gjëja e parë që ai bën është të sulmojë dikë tjetër. Në mënyrë të pandërgjegjshme ai është i zemëruar me veten e tij, ndoshta sepse nuk i ka vlerësuar gjërat siç duhet, ose për faktin se nuk ka bërë gjënë e duhur. Duke mos e perceptuar atë që ndjen, ai e ka të vështirë ta lejojë veten të dashurohet dhe të lërë gjërat të ndodhin, por edhe të demonstrojë dhe deklarojë dashurinë e tij.

Kjo do të përcaktojë dy lloje të ndryshme të rriturish, që i bashkon megjithatë ndjenja e vazhdueshme që ata përjetojnë: pakënaqësia. Në rastin e parë, çdo gjë që ata bëjnë do të duhet të jetë e përshtatshme për të kënaqur në mënyrë të pandërgjegjshme prindërit e tyre; në të dytën ata do të perceptojnë se nuk po bëjnë kurrë aq sa duhet për t'i kënaqur ose për t'i bërë të lumtur. Vështirë se do ta kuptojnë këtë plagë, e para sepse për ta është normale (kështu janë edukuar që në vitet e para të jetës); së dyti sepse të njohësh plagën është si t'u bësh keq prindërve.

Në marrëdhënie ata presin që partneri i tyre të korrespondojë me pritshmëritë e tyre. Ata janë shumë kërkues, nisur nga përkushtimi absolut në çift. Ata

gjithmonë veprojnë që të ndihen të drejtë. Për të bërë gjithçka me saktësi, do t'i duhet kohë, e cila gjithmonë do të jetë shumë pak dhe shpesh do të jetë vonë, edhe nëse nuk i pëlqen, sepse duhet të përgatiten.

Në fëmijëri e ka përjetuar si problem autoritetin, sepse është detyruar ta pranojë dhe tani e ka frikë; kur i kërkohet diçka, nga frika se mos i besohet, e përjeton atë me një ndjenjë padrejtësie.

Marrëdhëniet me të tjerët

Duke dashur gjithmonë të ketë të drejtë, ai i kushton shumë rëndësi "gjërave të merituar". Në fakt, ai përpjeket të shmangë marrjen e shpërblimit që beson se është i pamërituar, ashtu siç vërehet shpejt kur dikush, sipas tij, nuk e meriton vëmendjen apo shpërblimet që merr. Pikërisht për shkak të ndjenjës së fortë të padrejtësisë, ai shpesh tërheq në jetën e tij situata që i konsideron të padrejta, edhe brenda familjes. Vetë ngurtësia e tij do të thotë që ai gjithmonë do të bëjë më shumë se të tjerët që, përkundrazi, do të priren të lajnë duart. Vetëm shërimi i plagës do të lejojë që situata të tilla të fillojnë të pakësohen ose të zhduken nga jeta e tij. Ai duhet

të mbajë gjithçka në rregull, madje mund të bëhet obsesiv në përpjekjen për të mbajtur gjithçka sipas kriterëve të veta. Gjithmonë mundohet t'i mbajë gjërat nën kontroll që të jenë "të drejta"... siç do ai. Duke i imponuar vetes shumë detyra, shpesh ngurtësia theksohet sepse të jesh perfekt në çdo gjë nuk është e lehtë. Ai ka një aftësi të madhe për të mos ndjerë dhimbje, kështu që vazhdon pafundësisht, dhe rrallë është i sëmure dhe nëse është, e vëren vetëm kur gjendja përkeqësohet.

Maska reflektohet edhe në trup

Ngurtësia tipike e individit e bën atë të ftohtë si në ton ashtu edhe në lëvizje. Ashtu si qëndrimi, edhe trupi bëhet i ngurtë. Kjo maskë i bën ata që vuajnë prej saj, perfeksionistë të mëdhenj; le bën të përjetojnë zemërim, padurim, kritikë dhe intolerancë ndaj vetvetes.

Personi është shumë kërkues dhe nuk respekton kufijtë e tij. Sa herë që e mban veten nën kontroll, përmbahet ose tregohet i ashpër ndaj vetes, është shenjë se ka vendosur maskën e ngurtësisë. Prandaj, trupi bëhet i drejtë dhe jo fleksibël. Ai është gjithashtu i

ngurtë në lëvizjet e tij, madje mund t'i shtrëngojë këmbët dhe t'i rreshtojë me trupin. Kur kryqëzon këmbët dhe krahët, është për të mos ndjerë se çfarë po ndodh, dhe kur shtrëngon nofullën është për të mbajtur zemërimin.

Sidoqoftë, vështrimi i tij është i gjallë dhe i ndritshëm. Ai është i padrejtë me veten sepse kritikon veten dhe e ka të vështirë të shohë cilësitë e veta pozitive dhe gjërat e mira që bën. Ai vuan sepse sheh vetëm atë që nuk është bërë, ose vetëm gabimin e bërë. Ai priret të vuajë duke pasur vështirësi për t'i dhënë vetes gjërat që i japin kënaqësi.

Konkluzione

Ne duhet të pranojmë se askush nuk është i përsosur, madje as ne vetë; nuk ka asgjë të keqe të njohësh kufijtë e tu, të kërkojë dhe të pranosh ndihmë dhe të kesh njohjen e duhur. Lëndimi nga padrejtësia fillon të shërohet pasi personi i ngurtë i lejon vetes të jetë më pak perfeksionist, të bëjë gabime, të tregojë anën e tij më të brishtë, duke qarë ose duke kërkuar ndihmë, pa e gjykuar veten ose pa patur frikë se mos gjykohet dhe pa patur frikë se do të humbasë kontrollin. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



KOK-u shpërblen me 33 500 euro ekipin olimpik

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës ka vendosur t'i shpërblejë edhe këtë herë sportistët për suksesin dhe pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ekipi olimpik i Kosovës fitoi medaljen

e argjendtë me Distria Krasniqin dhe të bronztën me Laura Fazliun, të dyja nga sporti i xhudos. Të dyja medalistet olimpikë, krahas shpërblimit shtetëror, do të shpërblehen edhe nga KOK-u me nga 10 mijë euro secila. Trajneri i tyre, Driton

Kuka, do të shpërblehet me 5 mijë euro. Sukses është vlerësuar edhe vendi i pestë i Akil Gjakovës, që është suksesi më i madh në konkurrencën e meshkujve për ekipet olimpikë të Kosovës. Akilit do t'i jepen 4 mijë euro. Kampionia olimpikë

"Tokio 2020", Nora Gjakova, xhudistja Loriana Kuka dhe boksierja Donjeta Sadiku, që u kualifikuan me normë olimpikë, do të shpërblehen me nga 1 mijë euro, ndërsa pjesëmarrësve me ftesë të univerzalitetit, notarëve Hana Beiqi e Adell Shaboviq dhe



atletes Gresa Bakraqi, do t'u jepen nga 500 euro. Në total, shuma e ndarë është 33 500 euro.

Kosova synon fitore ndaj Rumanisë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të enjten ka përfunduar stërvitjen e fundit para ndeshjes ndaj Rumanisë, e cila zhvillohet sonte (e premte) nga ora 20:45 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Lajm i mirë për "dardanët" është fakti se të gjithë futbollistët janë në formë të mirë dhe të gatshëm për ndeshjen e parë në Ligën e Kombeve për këtë edicion. Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda është shprehur optimist para ndeshjes ndaj rumunëve, duke thënë "Kemi pasur disa ndeshje jashtë vendit, por tani është koha për të luajtur në shtëpi. Ekipi është përgatitur mirë dhe kemi shumë alternativa për ta nisur mbarë Ligën e Kombeve. Rumania është një ekip i fortë, por e kemi studiuar mirë dhe e dimë se si sulmojnë e si mbrohen, andaj



jam i bindur se do të fitojmë", ka thënë Foda, i cili nuk e la pa kritikuar fushën e stadiumit "Fadil Vokrri". "Për herë të parë do të luajmë edhe ne në fushën e re, por me aq sa pash, fusha

nuk është në gjendje perfekte, por çfarë mund të them është se luajmë në shtëpi dhe na nevojitet përkrahja e madhe nga publiku", ka shtuar ai. Ndërsa sulmuesi kryesor i Kosovës,

Vedat Muriqi ka kërkuar hakmarrje ndaj Rumanisë. "Jemi shumë optimistë dhe kemi bërë përgatitje maksimale. E njohim mirë Rumaninë dhe besojmë shumë në hakmarrje, por brenda vijave të fushës. Ne nuk ia bëjmë atyre, siç na bën ata neve në Rumani. Nëse fitojmë tre pikët, do të jetë goditje më e madhe për ta", tha Muriqi. Sulmuesi i Mallorcas foli edhe për konkurrencën në ekipin përfaqësues të Kosovës, duke u shprehur se është mjaftë i lumtur se konkurrenca po rritet. "Konkurrenca në sulm është shumë e madhe, por nuk ndihem aspak i rrezikuar. Më vjen mirë që Kosova ka aq shumë sulmues cilësorë. Jam shumë i lumtur kur i shoh lojtarë kaq cilësorë që do të luajnë për Kosovën edhe për shumë vite në vazhdim. Po ashtu lumturohen kur i shoh që po rriten e po zhvillohen së bashku me ne", ka deklaruar Muriqi.

Trajneri i Rumanisë: Nuk pres incidente

Trajneri i ri i Rumanisë, Mircea Lucescu foli në konferencë për medie para ndeshjes ndaj Kosovës. Ai u shpreh se ekipi që ai drejton tashmë ka fituar një përvojë të madhe me paraqitjen në Kampionatin Evropian "Gjermania 2024". "Është një ekip pak më ndryshe që nga hera e kaluar kur ishte këtu (për në Prishtinë). Rumania ka fituar më shumë përvojë që nga ajo kohë, pasi luajti edhe në Kampionatin Evropian të këtij viti. Është një ekip tejet i motivuar dhe një ekip që është i gatshëm të jap gjithçka nga vetja për të kaluar në një nivel tjetër", ka thënë ai. Lucescu, 79-vjeçar, foli edhe për atmosferën e mundshme që do t'i presë ata në "Fadil Vokrri". "Unë pres një atmosferë sportive. Ndeshja do të luhet në fushë. Nuk pres të ketë incidente, do të jetë 100% fair-play", ka thënë trajneri rumun.

Hidhet shorti për edicionin e ri në Superligën e Meshkujve

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) është hedhur shorti për edicionin 2024-25 në Superliga Meshkujt. Komisari i Garave në FBK, Faton Kurshumlja dhe asistentja ekzekutive në FBK, Rrezarta Kqiku, kanë bërë hedhjen e shortit në prani të përfaqësuesve të klubeve, derisa është transmetuar LIVE në faqen e

FBK-së në "Facebook". Kampionia aktuale e Kosovës, Trepça, në xhiron e parë do të ndeshet me Bashkimin, kurse në javën e parë do të ndeshen Vëllaznimi me Pejën, Proton Cable Prizreni me Sigal Prishtinën, si dhe Bora me Golden Eagle Yllin. Finalistët e fundit të "play-off"-it Trepça do të ndeshet me Golden Eagle Yllin në xhiron e dytë, ku në këtë

xhiro është derbi i parë prishtinas Sigal Prishtina - Bora, kurse në javën e tretë është derbi tjetër i qytetit Proton Cable Prizreni - Bashkimi. Në xhiron e katërt është derbi Trepça - Sigal Prishtina, në të pestin Sigal Prishtina - Peja dhe të gjashtin Trepça - Peja. Edicioni i ri do të fillojë më 14/15 shtator, që pritet të jetë një nga më interesantet në vitet e fundit.



Orari

Java 1
Më 14/15 shtator takohen:
Bashkimi - Trepça
Vëllaznimi - Peja
Proton Cable Prizreni - Sigal Prishtina
Bora - Golden Eagle Ylli

Java 2
Më 21/22 shtator takohen:
Trepça - Golden Eagle Ylli
Sigal Prishtina - Bora
Peja - Proton Cable Prizreni
Bashkimi - Vëllaznimi


FFK-ja organizon kursin e radhës për Licencën UEFA C për trajnerë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës organizon kursin për trajnerë të Licencës UEFA C në bashkëpunim me platformën unike të mësimdhënies dhe mësimnxënies Edubreak. Kursi do të organizohet në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, ku

do të mbahen ligjëratat dhe stërvitjet. Ligjëratat dhe stërvitjet mbahen nga e hëna në të premten. Pjesëmarrja e plotë është obligative dhe nuk do të ketë nevojë për akomodim apo fjetje. Numri maksimal i pjesëmarrësve për këtë kurs do të jetë 24. Pagesa për pjesëmarrje në kurs është 350

euro, derisa kursi do të fillojë më 30 shtator. FFK-ja ka njoftuar edhe për kriteret për Licencën C: "Aplikacionet dhe formularët e regjistrimit të FFK-së të plotësuar, dy foto (dimensionet e pasaportës), certifikata shëndetësore (jo më e vjetër se gjashtë muaj), dëshmi që ai/ajo

nuk është dënuar dhe nuk është nën hetime për ndonjë veprë penale, dëshmi mbi edukimin (së paku diploma e shkollës së mesme), minimumi i moshës së kandidatit duhet të jetë 18 vjet". Federata e Futbollit ka njoftuar se aplikacionet mund të dorëzohen deri më 17 qershor.



Krasnodari e dëshiron Dakun

KRASNODAR, 5 SHTATOR - Fillimisht, ishte fjala se nuk do të largohej shpejt nga ekipi. Mirlind Daku është padyshim një hero te Rubini i Kazanit, veçse edhe heronjtë e kanë një çmim, dhe për sulmuesin kuqezi ka interesim. Mediet ruse informojnë se klubi i

Krasnodarit planifikon ta marrë 26-vjeçarin nëse shet sulmuesin kryesor të ekipit, Xhoni Kordoba. Këtë e thotë gazetari rus Ivan Karlov. Babai i Dakut deklaroi disa ditë më parë se djali i tij nuk do ta braktisë tani shpejt Rubinin, por transferimi mund të ndodhë në janar.

Besohet se Rubini do të kërkojë rreth 10 milionë euro për kartonin e sulmuesit të kombëtares shqiptare, dhe ky do të ishte një përfitim i madh për klubin. Kjo sepse Rubini e mori Dakun vetëm për 1.2 milion euro nga Osijeku i Kroacisë. Sulmuesi kuqezi

është futbollisti më i mirë i ekipit të trajnerit Rahimov, duke pasur 5 gola dhe 3 asistime në 7 ndeshje të Premierë Ligës së Rusisë, ndonëse për momentin është i dëmtuar. Ai nuk është grumbulluar në kombëtare në ndeshjet e Ligës së Kombeve tani në shtator.



Laçi dhe Kumbulla: Do të futemi në fushë për të fituar

TIRANË, 5 SHTATOR - Kombëtarja shqiptare do të udhëtojë drejt Pragës, aty ku do ta zhvillojë edhe ndeshjen e parë në Ligën e Kombeve ndaj Ukrainës në stadiumin "Epet Arena". Dy lojtarët kuqezi, Qazim Laçi dhe Marash Kumbulla, para nisjes drejt Pragës folën për "Fshf.org", duke treguar se si kanë shkuar përgatitjet dhe synimet e Shqipërisë në kompeticionin e Ligës së Kombeve. Qazim Laçi ka thënë se ndeshja e parë ndaj Ukrainës është shumë e veçantë për të, pasi do të luhet në stadiumin e klubit të tij, Sparta Prague. Mesfushori kuqezi vlerësoi dy kundërshtarët dhe shtoi se mbështetja e tifozëve është shumë e rëndësishme. "Mezi po presim që të vazhdojmë një aventurë të re në kompeticionin e Ligës së Kombeve. E kemi për detyrë të bëjmë maksimumin pas paraqitjeve në Evropian. Për mua është një ndeshje e veçantë me Ukrainën sepse luajmë në Çeki te stadiumi im", ka thënë Laçi, i cili më pas ka folur edhe për ndeshjen



me Gjeorgjinë në "Air Albania": "Janë kundërshtarë të fortë, edhe Ukraina dhe Gjeorgjia ishin pjesë të Evropianit. Është shumë e rëndësishme që tifozët të vijnë e të na mbështesin si në Gjermani. Do të jetë një moment i bukur për të gjithë lojtarët dhe sidomos për të gjithë tifozët që do të vijnë në stadiumin 'Air Albania', pasi është ndeshja e parë pas Evropianit. Kemi shumë nevojë për tifozët për mbështetjen e tyre, si ndaj Gjeorgjisë dhe në ndeshjet e tjera". Në anën tjetër Marash Kumbulla u shpreh se ndeshja e parë ndaj Ukrainës është shumë e vështirë, por theksoi se Kombëtarja do të futet në fushë vetëm për fitore. Mbrojtësi kuqezi tregoi se përgatitjet kanë shkuar shumë mirë dhe se ekipi është gati për ndeshjen ndaj Ukrainës. Ndër të

tjera, Kumbulla ka thënë se në "Air Albania" me mbështetjen e tifozëve gjithçka do të jetë më e thjeshtë. "Janë kundërshtarë shumë të vështirë, sidomos Ukraina. Si gjithmonë do të futemi në fushë për të fituar. Me Gjeorgjinë kemi edhe tifozat pasi luajmë në shtëpinë tonë. Besoj se grupi është gati, jemi stërvitur me intensitet të fortë dhe jemi gati për dy ndeshjet. Ukraina ka ekip shumë të fortë, ka lojtarë të mirë por edhe ekipi jonë ka shumë cilësi. Do të jetë një ndeshje e ekuilibruar dhe e vështirë, shpresojmë që të fitojmë", ka thënë Kumbulla. "Ndeshja ndaj Gjeorgjisë dhe objektivi i Shqipërisë në Ligën e Kombeve? Tifozët do të na mbështesin si gjithmonë, ashtu si në Evropian në Gjermani por edhe në shtëpi në Tiranë. Edhe ndeshja ndaj Gjeorgjisë do të jetë e vështirë, por me mbështetjen e tifozëve do të jetë më e thjeshtë. Do të futemi në fushë për të fituar, por të shohim dy ndeshjet e para. Objektivi është gjithmonë për të fituar".

SHKURT

Broja paraqitet tek Evertoni

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, është paraqitur tek Evertoni. Sulmuesi kuqezi u la jashtë planeve të trajnerit Enzo Maresca, kështu që ai e pati me detyrim ta gjejë një skuadër të re. Për lojtarin ishin interesuar shumë nga Anglia dhe Italia, mirëpo Evertoni arriti t'i sigurojë shërbimet e tij. Broja assesi nuk po rehatohet me klube, pasi nga janari kishte qenë i huazuar te Fulhami, por as aty nuk i gjeti minutat e duhur. Sulmuesi shqiptar më parë ka luajtur edhe te Southamptoni në Angli dhe Vitesse në Holandë.

Lazio e lë Hysajn jashtë Serisë A

Kombëtarja është kthyer në një bekim për Elseid Hysajn, mundësia e vetme për të për të zhvilluar ndeshje zyrtare. Anësori kuqezi po përjeton momentin e tij më të vështirë në karrierë pasi Lazio e ka "fshirë" nga çdo turne. Pasi e lanë jashtë listës së Evropa Ligës, drejtuesit e klubit kryeqytetas e lanë jashtë edhe nga lista e lojtarëve të përfshirë në Serinë A. Në këto kushte, Hysaj sponstohet në tribunë duke mos pasur asnjë shans për të luajtur asnjë minutë të paktën deri në janar, nëse arrin të largohet nga kryeqyteti. Kjo është një formë hakmarrjeje nga ekipi i Lazios pasi mbrojtësi shqiptar nuk u largua gjatë merkatos së verës, në një kohë kur drejtuesit e klubit ia kishin bërë të qartë se nuk bënte pjesë në planet e trajnerit për sezonin e ri, por Hysaj vendosi të qëndronte. Pas kritikave të shumta në "Euro 2024", Hysaj përballet me një tjetër realitet të hidhur.

Interi refuzon ofertën prej 35 milionë eurosh për Asllanin

Kristjan Asllani nuk është ende lojtar kryesor i Interit, por mosha e re e favorizon. Ai është ende në kohë për të shkruar një kapitull të bukur me fanellën zikaltrë. Këtë ide kanë edhe drejtuesit e klubit italian, të cilët kanë refuzuar 35 milionë euro për shërbimet e mesfushorit shqiptar. Fiorentina ka kërkuar të përfitojë nga situata e paqartë e legionarit kuqezi, duke bërë një ofertë mjaftueshëm të lartë. Interi ka refuzuar dhe madje nuk ka pranuar të negociojë, të paktën deri verës e ardhshme. Shitja e Asllanit mund të ndodhë vetëm në rast të një oferte tepër të lartë. Me pak fjalë, vetëm ndonjë klub anglez mund ta përballojë shifrën që duan zikaltrit. Trajneri Inzaghi vazhdon të besojë te mesfushori Hakan Çalhanoglu. Edhe pse 30-vjeçarit vazhdojnë t'i shtohen vitet mbi supë, klasi i tij nuk diskutohet. Asllani ka ende punë për të bërë.

Hummels paraqitet te Roma

Mats Hummels është paraqitur te skuadra e Romës, duke nënshkruar kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një tjetër vit dhe besohet se do të jetë me vlerë tre milionë euro në sezon. Ai ka zgjedhur fanellën me numrin 15. Reprzentuesi gjerman do të mbushë 36 vjeç në dhjetor dhe e kaloi gjithë karrierën në Bayern Munchen dhe Borussia Dortmund. Kontrata e tij me këtë të fundit u lejua të përfundonte më 30 qershor dhe ai ishte në bisedime me klube të shumta, përfshirë Real Sociedad.

Guardiola: Mulleri në nivel me Messin dhe Ronaldon

MANCHESTER, 5 SHTATOR - Kur tifozët e futbollit filozofojnë për futbollistët më të mirë të të gjitha kohëve, zakonisht dalin emra si Pele, Diego Maradona, Franc Beckenbauer, Lionel Messi apo Cristiano Ronaldo. Thomas Muller shfaqet rrallë në këtë debat. Për ish-trajnerin e Bayernit, Pep Guardiola, bavarezi ndodhet në lupën e tij pikërisht në këtë kategori. "Asnjë lojtar tjetër nuk është si Thomas Muller. Ai është një nga lojtarët më të mëdhenj në historinë e Bayernit dhe futbollit. Jo vetëm për shkak të titujve të tij të shumtë, por sepse ai është gjithmonë aty kur skuadra e tij ka nevojë për të", theksoi Guardiola në një intervistë për revistën e klubit të "Bayernit 51".



Edhe pse Mulleri rrallë përmendet në të njëjtën frymë si Messi apo Ronaldo, Pep është plotësisht i bindur se askush nuk e nënvlerëson 34-vjeçarin: "Tifozët e futbollit në mbarë botën e dinë vlerën e Thomasit në fushë. Është një lojtar i zgjuar, i paparashikueshëm, i cili e di gjithmonë se ku të lëvizë". Përveç aftësive të tij në lojë, katalanasi është gjithashtu një tifoz i Mullerit

si person: "Ajo që më ka lënë më shumë mbresa gjithmonë te sulmuesi i Bayernit ishte sa modeste është festa e tij. Kur futbollistët shënojnë një gol këto ditë, ata vrapojnë vetëm dhe festojnë. Thomas është ndryshe, ndoshta më bujar, ai veçanërisht dëshiron t'i përqafojë shokët e tij të skuadrës pasi shënon". Guardiola ka punuar me Mullerin në "Allianz Arena" për tre vjet. 53-vjeçari kujton veçanërisht një moment: "Në Ligën e Kampioneve 2016 ne luajtëm kundër Juventusit, po humbim 2-1. Ai shënoi golin e barazimit 2-2 që na çoi në kohën shtesë. Ne e fituam ndeshjen 4-2. Ja pra kush është Mulleri", ka përfunduar Guardiola.

Eberl: E pakuptueshme mungesa e Musialas në listën për 'Topin e Artë'

Drejtori sportiv i Bayern Munichut, Max Eberl, ndihet i befusuar me mungesën e Jamal Musialas në nominimet për

"Topin e Artë". Ylli gjerman i Bayernit, Musiala, nuk u përfshi në listën e 30 lojtarëve për "Topin e Artë" duke e lënë të

zemëruar drejtorin e Bayernit, Eberl. "Jemi shumë të befusuar që në këtë listë mungon Jamal Musiala. Është krejtësisht e

pakuptueshme", ka thënë Eberl për DPA. Musiala ishte brilant për Bayernin sezonin e kaluar duke shënuar 12 gola dhe duke

shtuar 8 asistime. Ai shënoi tre gola dhe e ndihmoi Gjermaninë të arrinte në çerekfinale të "Euro 2024".



**KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI**
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriaz" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com, info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025

01.07.2024 deri më 30.09.2024

STUDIME BACHELOR	STUDIME MASTER
1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar) 2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar) 3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)	1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar) 2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)

Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR	Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER
Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar) Certifikatën e lindjes, Kopja e letërnjoftimit, Dy foto.	Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar) CV Certifikatën e lindjes Kopjen e letërnjoftimit Dy foto

www.kolegjbiznesi.com,
info@kolegjbiznesi.com

038/045/044- 500 878
049/ 048- 500 – 878
029-230-555 : 044 131027



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHBALLJE TË VOGLA <<

- Vjollca Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Isuf Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Edison Kryeziu nga Xërxa KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të Gjinnazit "Ukshin Hoti" Krush e Madhe Rahovec.

- Aulona Rama shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I dhe II te SH.M.L.E. "Hasan Prishtina".

- Zoja Bimbashi shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe IV te SH.M.L.M "Xheladin Deda".

- Adelina Isufi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Trepça".

- Qerdhe për fëmijë "Dagis Center" SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 810550922.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 1350 /1
 Datë: 05.09.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së Qendrës së Kompetencës në Skenderaj shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të shkollës Mesme të Qendrës së Kompetencës në Skenderaj, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensione turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

Agjensioni ose kompania duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së;
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore;
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë;
- Agjensioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit;
- Agjensioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjensioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Viti i prodhimit të autobusëve;
- Agjensioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një para kontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës 2024;
- Kategorizimi i hoteleve në bazë të yjeve;
- Agjensioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit;
- Agjensioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës;
- Agjensioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike;
- Agjensioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulturo-historike;
- Agjensioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për dy vitet e fundit (2022-2023) në vlerë prej 95.000 euro (nëntëdhjetë e pesë mijë euro);
- Agjensioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targat e autobusit që do të vozisin;
- Agjensioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.

Kushtet tjera:

- **Nisja duhet të bëhet më dt.26.09.2024 dhe kthimi më dt.30.09.2024-që i bje se duhet të kalohen katër netë akomodimi.**
- Një deklaratë e shkruar nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi;
- Dëshmi (origjinale, kontratë) mbi rezervimin e hoteleve sipas ofertës;
- Dëshmi mbi sigurimin e ekzekutimit, të kontratës në vlerë prej 10%, të vlerës së kontratës;
- Të sigurohet pasioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Një të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.
- Agjensioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Shkodër
- Vërtetimi i ATK-së i cili ka vlefshmëri
- Vërtetimi i taksave komunale për vitin 2023
- Vërtetimi i tatimit në pronë për vitin 2023

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Shkollës Kriër për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategorizimi i hoteleve në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve numri, dhe viti i prodhimit të autobusëve
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në shkollë, pasdite në të njëjtën ditë.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar t'i dorëzojnë në Agjencinë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur (AAAPARr) në Prishtinë rruga "Agim Ramadani" ndërtesa MASHTI-II kati i III-të, gjatë orarit 08:00-16:00.

Hapjen e ofertave e bën Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensione turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotësojnë kriteret e caktuara nga KDSH-ja.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike.

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus 3 ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe AAAPARr, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet në ditën e mbylljes së konkursit në ambientet e Shkollës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Autolarje Pro" SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812124246 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa "Autolarje Pro" D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812124246 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Autolarje Pro" L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 812124246 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

